



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

788/1

16.05.2022

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM NË PROGRAMIN EDOKTORATËS PËR  
VITIN AKADEMIK 2021 – 2022, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË  
LËVIZJES TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve të Tiranës (FSHL), në mbledhjen e datës 16 Maj 2022, vendosi Hapjen e Aplikimeve për Programin e Doktoratës në Shkenca Sportive për vitin akademik 2021 – 2022, në nënfushat:

**Fusha kryesore e kërkimit: “EDUKIM FIZIK”**

**Nënfusha: “Edukimi Fizik dhe Sport”**

Qëllimi themelor i programit të doktoratës në nënfushën “Edukimit Fizik dhe Sport” është **thellimi i njohurive shkencore dhe përvetësimi i metodave bashkëkohore të kërkimit shkencor nga kandidatët që vijojnë ciklin e tretë të studimeve doktoratë në fushën e Shkencave Sportive.** Ky program ka për objektivi t’u ofrojë kandidatëve mundësinë që të ndërtojnë kompetencat e nevojshme shkencore, për të ushtruar aktivitetin e kërkimit pranë institucioneve të arsimit të lartë, institucione shtetërore, të pavarura, qëndrore e vendore, etj.

Në këtë kontekst, Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit si një njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, UST, me një historik dhe rekorde të gjata akademike, me qëllimin për t’i shërbyer shkencës së aplikuar në fushën e sportit dhe të edukimit fizik në vendin tonë ofron dhe do të zhvillojë në vijimësi këtë program studimi. Ky program synon të përgatisë studiues të pavarur në kërkimet bazë dhe të aplikuara si kërkesë për të siguruar karrierë të suksesshme në akademi, institucionet të administratës publike qoftë kjo e nivelit vendor apo qendror dhe me tej.

Fakulteti Shkencave të Lëvizjes ka kapacitet e nevojshme për të përmbushur detyrat e akteve ligjore/nënligjore në lidhje me ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës, pasi në tërësinë e tij ky Fakultet ka pedagogë me titullin profesor dhe profesorë të asociuar dhe drejtimi shkencor i tyre do të jetë i duhuri dhe i përshtatshëm për të realizuar objektivate këtij cikli. Gjithashtu, FSHL-ja ka realizuar disa marrëveshje me aktorë të ndryshëm, të cilat do të mbështesin kërkimin shkencor në disa mënyra, siç është literatura e nevojshme, shkëmbimi i eksperiencave me Fakultete dhe Institutin e Kërkimeve të UST-së, si dhe me partnerë jashtë vendit.

**AFATI I APLIKIMIT 16 Maj 2022 – 17 Qershor 2022**

***Hapja e programeve bazohet në legjislacionin si vijon:***

**Ligji nr. 80/2015** “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar;

VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’, i ndryshuar;

VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar;

VKM nr. 75, datë 12.2.2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”;

**Urdhërin Nr. 95, datë 25.02.2022** të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve të Tiranës”;

**Udhëzimi** i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar;

**Udhëzimi** i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 16, datë 08.07.2019, “Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”;

**Udhëzimi** i përbashkët i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor;

**Udhëzimi** i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 18.12.2019 “Për Krijimin dhe administrimin e rregjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”;

**Rregulloret** e miratura të UST-së me nr. 38, datë 30.03.2021, dhe nr. 78, datë 29.04.2021 “Mbi Organizimin e Programeve të Studimeve të Ciklit të Tretë të Doktoraturës, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”.

**Udhëzimi** i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 1, datë 14.1.2020 "Për okumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 31.3.2021.

**Udhëzimi** i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe

procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor".

Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-te Statuti i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

**KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR T'U PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË SHKENCA SPORTIVE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES, UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

1. Diplomë universitare "Master i shkencave" në UST;
2. Diplomë e sistemit të vjetër 4-vjeçar në UST;
3. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në rregulloren e saj;
4. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
5. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 4-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale;
6. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SA i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
8. Vetëm kandidatet të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme, kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

**KUSH MUND TË APLIKOJË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES**

*\* Studimet e doktoratës këtë vit akademik ofrohen me prioritet për personelin akademik me kohë të plotë në UST që e kanë detyrim ligjor kualifikimin e tyre në nivelin e tretë të studimeve, për shkak të punësimit si personel akademik në IAL.*

## DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Kërkesa e studentit kandidat për të ndjekur programin e studimit të doktoratës në përputhje me fushën e shpallur nga njësia ku aplikon, përfshihet në dosjen personale.

Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë Sekretarise Mesimore, tek Sekretarja përgjegjëse. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 09:00 – 14:00

### Përmbajtja e Dosjes Individuale

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
2. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
3. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë etj., firmosur nga udhëheqësi sipas Aneksit 3;
4. Letër motivimi;
5. CV personale;
6. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
7. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, të shoqëruara me suplementet e diplomave përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
8. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
9. Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës;
10. Dy fotografi;
11. Dy rekomandime nga persona të kategorisë “Profesor” ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
12. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UST;
13. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas legjislacionit në fuqi;
14. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar në institucione të tjera akademike;
15. Mandat pagese për tarifën e aplikimit.

**PROFESORATI SIPAS FUSHËS SË EKSPERTIZËS**

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (prof./prof. as.) gradë shkencore në:	Institucioni	Njësia/ grupi i njësive bazë	Lloji i angazhimit
1	Dhimitraq Prifti	Prof.Dr. Fiziologji e AF	UST/FSHL	Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
2	Dhimitraq Skënderi	Prof. Dr. Stërvitje Sportive	UST/FSHL	Dep. Sporteve Individuale	Me kohë të plotë
3	Bardhyl Misja	Prof.Dr. Edukim fizik	UST/FSHL	Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
4	Fatos Gjata	Prof. Dr. Edukim Fizik	UST/FSHL	Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
5	Juel Jarani	Prof.Asc.Dr. Edukim Fizik dhe Shëndet/Basketboll	UST/FSHL	Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
6	Kujtim Kapedani	Prof.Asc.Dr Stërvitje Sportive/ Sporte ndeshëse	UST/FSHL	Dep. Sporteve Individuale	Me kohë të plotë
7	Fatbardha Kovaçi	Prof.Asc.Dr. Stërvitje Sportive/ Atletikë	UST/FSHL	Dep. Sporteve Individuale	Me kohë të plotë
8	Aida Shehu	Prof.Asc.Dr. Stërvitje Sportive/ Volejball	UST/FSHL	Dep. Sporteve Kolektive	Me kohë të plotë
9	Anesti Qeleshi	Prof.Asc.Dr Aktivitet Fizik dhe Shëndet/Didaktike	UST/FSHL	Dep. Edukimit dhe Shëndetit	Me kohë të plotë
10	Abdyl Kuriu	Prof. Asc.Dr. Stërvitje Sportive/ Futboll	UST/FSHL	Dep. Sporteve Kolektive	Me kohë të plotë
11	Edison Ikonomi	Prof. Asc.Dr. Stërvitje Sportive/ Gjymnastikë	UST/FSHL	Dep. Sporteve Individuale	Me kohë të plotë

Aneksi 3

FORMULAR PËR PROPOZIMIN E TEMËS KËRKIMORE SHKENCORE TË  
KANDIDATIT PËR STUDENT NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE TË  
DOKTORATURËS

Kandidati/Studenti-ja:	
Viti Akademik:	

Udhëheqësi Shkencor:	
----------------------	--

<b>Tema e Projektit Kërkimor Shkencor</b>

<b>Fusha e Studimit</b>

<b>Nën-fusha e Studimit</b>

<b>Lloji i Studimit</b>

<b>Kohëzgjatja e Projektit Kërkimor</b>	<b>Data e Fillimit të Projektit Kërkimor</b>

<b>Abstrakti</b> (jo më shumë se 500 fjalë)

<b>Identifikimi i Problemët dhe Rëndësia e Zgjidhjes së tij</b> (duhet të shprehet qartë rreth e literaturë mbështetëse për projektin dhe rëndësia e studimit, jo më shumë se 1000 fjalë)

<b>Qëllimi</b> (jo më shumë se 150 fjalë)



**Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e II**  
 (Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e kapitujve të cilat duhet të përkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rëtin përkatës, ndërsa M i referohet muajve)

Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Përshkrimi i Kapitujve që do të Realizohen	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M
1-												
2-												
3-												
--												

**Grafiku i Plani i Punës së Projektit Shkencor për Vitin e III**  
 (Plani i punës do të zhvillohet mbi bazën e kapitujve të cilat duhet të përkruhen në tabelën e dhënë. Specifikoni kohën përkatëse me X ose duke e mbushur me ngjyrë katrorin/rëtin përkatës, ndërsa M i referohet muajve)


Koha	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Përshkrimi i Kapitujve që do të Realizohen	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M	M
1-												
2-												
3-												
--												

**Buxheti i Projektit Kërkimor Shkencor**  
 (sipas zërave dhe në total – në lekë, me pika dhe sa më konçiz)

Studenti-ja Kandidat/Msc. Emri, Mbiemri	Data	Nënshkrimi

Udhëheqësi Shkencor/Titulli Emri, Mbiemri	Data	Nënshkrimi

DEKANI  
 Prof. Dr. Dhimitër DRIFTI



REKTORI  
 Prof. Dr. Arnon KALLA

